



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 151 Datë 10.06.2022

MBI

**KËRKESËN E SHOQËRISË “SA-GLE KOMPANI” SH.P.K. PËR DHËNIEN E
AUTORIZIMIT NGA ERE PËR NDRYSHIMIN E ORTAKUT QË
KONTROLLON INTERESAT E SAJ**

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 66 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; si dhe nenit 15, të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 10.06.2022, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 900/1 prot., datë 08.06.2022 të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes “Në lidhje me kërkesën e shoqërisë “SA-GLE KOMPANI” sh.p.k. për dhënie autorizimit nga ERE për ndryshimin e ortakut që kontrollon interesat e saj”,

Konstatohet se:

- Shoqëria “SA-GLE KOMPANI” sh.p.k., është licencuar në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, me vendimin e bordit të ERE-s nr. 123, datë 29.08.2012, për një afat 30-vjeçar.
- Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 633 prot., datë 05.05.2022, ajo ka paraqitur kërkesë dhe dokumentacion për dhënie autorizimit nga ERE për ndryshimin e ortakut që kontrollon interesat e saj.
- Në lidhje me transferimin e kuotave të kësaj shoqërie, është depozituar shkresa e Zyrës Përmbarimore Private “TDR GROUP” sh.p.k., protokolluar në ERE me nr. 417 prot., datë 29.03.2022, “Urdhër për vendosjen e masës së sigurimit”, me anë të së cilës është informuar ERE dhe i është vënë në dispozicion Vendimi për vendosjen e masës së sigurimit nr. 1176 Akti, datë 14.01.2019 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Tiranë. Me anë kësaj shkrese i kërkohet ERE-s që të vendosë masën e sekuestros konservative mbi të drejtat që përfiton debitori, shoqëria “ERNIKU” sh.p.k. nga kontrata e Koncesionit nr. 2901 Rep., nr. 395 Kol., datë 14.09.2009, lidhur midis Autoritetit Kontraktues, Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE), dhe shoqërisë koncesionare “ERNIKU” sh.p.k., duke ndaluar çdo lloj dhënie miratimi nga ERE për transferimin apo tjetërsimin e kuotave, sipas kontratës së shitjes së pasurisë së luajtshme (kuota kapitali) Nr. 9473 Rep., nr. 3091 Kol., datë 09.11.2021,

të depozituar bashkëlidhur shkresës së sipërcituar. Referuar përcaktimeve të kësaj kontrate, shoqëria “ERNIKU” sh.p.k., i shet shoqërisë “AG Hpower & Construction” sh.p.k., 100% të kuotave që ai zotëron te shoqëria “SA-GLE KOMPANI” sh.p.k.

- ERE nëpërmjet shkresës me nr. 316/3 prot., datë 06.04.2022, njoftoi zyrën e përmbarimit se nuk ka marrë asnjë kërkesë dhe nuk ka asnjë vendim për dhënien e autorizimit për transferimin e 100 % të kuotave të shoqërisë “SA-GLE KOMPANI” sh.p.k. Gjithashtu duke qenë se vendimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Tiranë, daton më 14.01.2019 dhe duke pasur parasysh faktin se masa e sigurimit është një masë e përkohshme, ERE i kërkoi Zyrës së Përmbarimit informacion mbi statusin e procesit gjyqësor për të cilin është marrë kjo masë sigurimi.
- Në përgjigje të sa kërkuar nga ERE, Zyra e Përmbarimit ka bërë me dije se është urdhëruar heqja e sekuestros mbi kuotat dhe aksionet që shoqëria “ERNIKU” sh.p.k. zotëron te shoqëria “SA-GLE KOMPANI” sh.p.k., bazuar dhe në deklarin e debitorit të depozituar pranë saj, se duke marrë parasysh të gjitha pasojat ligjore nuk do të bënte asnjë transaksion për tjetërsimin e kuotave, por heqja e kësaj mase deri në rivënien e saj do të shërbente për ristrukturimin e kredisë që debitori ka në një bankë të nivelit të dytë, me qëllim mosrëndimin e situatës ekonomike të këtij të fundit, çka do të shërbente dhe për zbatimin e vendimit në proces ekzekutimi. Më tej nga ana e Zyrës së Përmbarimit risillet në vëmendje Urdhri nr. 317, datë 29.03.2022 dhe regjistrimi i sekuestros përkatëse nga ana e Regjistrimit të Barrave Siguruese.
- Në vijim të sa më sipër dhe pas depozitimit të aplikimit nga shoqëria “SA-GLE KOMPANI” sh.p.k., u vlerësua e arsyeshme zhvillimi i një seance dëgjimore në datën 30.05.2022, me përfaqësues të shoqërisë “ERNIKU” sh.p.k., “AG Hpower & Construction” sh.p.k., e Zyrës Përmbarimore Private “TDR GROUP”, si dhe avokati i shoqërisë “HAZIRI” sh.p.k., si person i interesuar, për të sqaruar dhe qartësuar statusin e kuotave të shoqërisë “SA-GLE KOMPANI” sh.p.k.
- Për sa bërë me dije nga palët në seancë, duke marrë në konsideratë se për heqjen e sekuestros mbi kuotat që shoqëria “ERNIKU” sh.p.k. zotëron te shoqëria “SA-GLE KOMPANI” sh.p.k. dhe transferimi i tyre te shoqëria “AG Hpower & Construction” sh.p.k., është depozituar një kallëzim penal pranë Prokurorisë dhe palët janë duke negociuar ndërmjet tyre për zgjidhjen e kësaj çështjeje, vlerësohet që të pezullohet vendimmarrja e bordit të ERE-s mbi kërkesën e të licencuarit, shoqërisë “SA-GLE KOMPANI” sh.p.k., për dhënien e autorizimit nga ERE për ndryshimin e ortakut që kontrollon interesat e saj, derisa të shprehen organet kompetente me vendim të formës së prerë për këtë çështje.
- Në këto rethana, shoqëria “SA-GLE KOMPANI” sh.p.k. ngarkohet me detyrimin për të dokumentuar në ERE vendimin përfundimtar për këtë çështje.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Pezullimin e vendimmarrjes së bordit të ERE-s në lidhje me kërkesën e shoqërisë “SA-GLE KOMPANI” sh.p.k., për dhënien e autorizimit nga ERE për ndryshimin e ortakut që kontrollon interesat e saj.
2. Shoqëria “SA-GLE KOMPANI” sh.p.k. duhet të dokumentojë në ERE vendimin përfundimtar të organeve përkatëse në lidhje me heqjen e sekuestros mbi kuotat dhe transferimin e 100% të kuotave të saj.
3. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, të njoftojë palët e interesuara dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s,- brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.